

---

## PLAN PROGRAMI I SPECIALIZIMIT SËMUNDJET E DHËMBIT ME ENDODONCION

---

---

KOHËZGJATJA E SPECIALIZIMIT- 36 muaj

Sëmundjet e dhëmbit me endodoncion është specializim stomatologjik. Mirret me të gjitha llojet e sëmundjeve të indeve të forta të dhëmbit dhe endodonciumit, me proceset e zhvillimit të indeve të forta të dhëmbit, shkaktarët e kariesit dhe sëmundjeve të pulpës, prevencen dhe shërimin e indeve të forta të dhëmbit, të pulpës dhe strukturave periradikulare, aplikimin e materialeve të reja dhe teknikat e shërimit me mbushje.

Plani i specializimit:

SËMUNDJET E DHËMBIT ME ENDODONCION	26 muaj
KIRURGJIA ORALE	2 muaj
PARADONTOLOGJIA ME MJEKËSI ORALE	3 muaj
PROTETIKA STOMATOLOGJIKE	1 muaj
MJEKËSIA INTERNE- DIABETOLOGJI	1 muaj
PUSHIMI VJETOR	3 muaj

Programi i specializimit:

---

SËMUNDJET E DHËMBIT ME ENDODONCION - 26 muaj

Specializanti është i detyruar ti kaloj 26 muaj në QKSUK në kuadër të aftësisimit teorik dhe praktik.

Aftësimi teorik në kuadër të specializimit përfshinë punën seminarike dhe ligjeratat me këto përmbajtje:

- zhvillimi embrional i indeve të dhëmbit me vështrim të veçant në ndryshimet patologjike të strukturave të forta të dhëmbit,
- përbërja kimike dhe ndërtimi histologjik i strukturave të forta të dhëmbit,
- specifikat fiziologjike të pulpës së dhëmbit dhe indit periradikular,

- çrregullimet në strukturën e indeve të dhëmbit (çrregullimet gjenetike, çrregullimet gjatë zhvillimit),
- çrregullimet e shkaktuara nga shkaktarët lokal dhe infektivo-toksik,
- diskolorimet e strukturave të dhëmbit,
- dëmtimet fiziko-kimike të dhëmbit,
- shkaktarët e kariesit të dhëmbit (mikroflora, shkaktarët lokal, dhe të përgjithshëm),
- pështyma dhe kariesi i dhëmbit, ndikimi i ushqyeshmërisë në zhvillimin e kariesit, aspekti imunologjik i kariesit të dhëmbit, epidemiologjia e kariesit, proceset resorptive të strukturave të dhëmbit, testet për zbulimin e hershëm të kariesit të dhëmbit,
- trauma akute dhe kronike e dhëmbit,
- funksioni i pulpës, ndryshimet patologjike në indin pulpar dhe periradikular, pasqyra histomorfologjike, citokimike, citomorfologjike dhe histokimike e indit të sëmuar pulpar dhe strukturave periradikulare,
- kompleksi pulpoparodontal, aspektet mikrobiologjike dhe imunologjike të sëmundjeve pulpare dhe periradikulare, mineralizimet patologjike,
- materialet dentale, materialet për stimulimin e pulpës dhe formimin e dentinës së re, amalgamet dentale, materialet kompozite, glass-ionomer cementet, adhesivët e dentinës.

Seminarët mbahen një herë në javë në kohëzgjatje prej 2 orëve. Specializanti përgatitë punimin seminarik në formë të shkruar të cilën e prezanton dhe merrë pjesë në diskutim.

#### Aftësimi praktik:

Specializanti fillon aftësimin praktik në Departamentin e Sëmundjeve të Dhëmbit në QKSU- Prishtinë.

Mentori në përputhshmëri me programin e specializimit organizon renditjen dhe zbatimin e programit praktik, duke shfrytëzuar mundësinë e ofrimit të të arriturave të reja teorike dhe praktike në këtë lëmi.

Specializanti trajnohet për çasjen bashkëkohore ndaj pacientit, kryen kërkimet klinike dhe laboratorike (anamneza, inspektimi kariesit të dhëmbit, mbushjeve ekzistuese, ndryshimeve prezente, ndryshimeve të ngjyrës së mbushjeve) me qëllim të vënjës së diagnozës së drejtë.

Sjellë planin e shërimit (shërimin sistematik, veprimet përgaditore, veprimet korrektuese)  
Në mënyrë të pavarur kryen veprimet terapeutike duke shfrytëzuar përvojat bashkohore  
në veprimet restaurative si dhe në shërimin endodontik të pulpës.

Përcakton diagnozën e lëndimeve të përbëra traumatike të kurorës dhe rrënjës së dhëmbit,  
planifikon shërimin dhe ndërmerret të gjitha veprimet për shërimin e tyre.

Përcjellë sistematikisht kazuistikën endodontike, zbulon shkaktarët dhe planifikon  
mënyrën e shërimit të pulpopative dhe proceseve periradikulare.

Kujdes të veçantë i kushton proceseve të përbëra të dhëmbët me aberacione morfologjike  
të formës, numrit dhe madhësisë të kanaleve të rrënjëve.

Gjatë stazhit specialistik kandidati i nënshtrohet këtyre kolokviumeve:

- histologjia e indeve të forta të dhëmbit,
- patohistologjia e kariesit të dhëmbit,
- shkaktarët e kariesit të dhëmbit, pllaku dentobakteror, format e veçanta të kariesit të dhëmbit,
- teknika e preparimit dhe terapia me mbushje,
- rëndësia anatomike dhe fiziologjike e përbërjes së endodontit dhe indit periradikular,
- ndryshimet patologjike endodontike dhe periradikulare,
- materialet për dentinogjenezen reaktive, mjetet mbrojtëse për plagën dentinore,
- materialet kompozite, glassionomer cementet dhe adhezivët,
- shërimi pasendodontik i dhëmbit,
- mekanizmi i përcjelljes së ndjeshmërisë,
- teknika e shërimit të dhëmbëve të diskoloruar.

---

KIRURGJIA ORALE- 2 muaj

Specializanti njoftohet me bazat e kirurgjisë, lëminë e anesteziologjisë, ndërhyrjet kirurgjiko orale tek infeksionet odontogjene, përpunimet kirurgjike të dhëmbët e

traumatizuar, hemostaza, përpunimet kirurgjike të plagës, komplikacionet te aplikimi i anestetikëve, specifikat e anestezionit të përgjithshëm, shoku traumatik, reanimimi që në mënyrë të pavarur të kryen ndërhyrjet endodontiko kirurgjike.

Kolokvium

---

#### PARODONTOLOGJIA ME MJEKËSI ORALE- 3 muaj

Përfitimi i njohurive bazike nga parodontologjia, klasifikimi dhe epidemiologjia e sëmundjeve parodontale, njohuritë e reja për pllakun, pastaj ndikimin e ushqyeshmërisë, shkaktarëve të jashtëm dhe të brendshëm në zhvillimin e sëmundjeve parodontale, diagnostikën e sëmundjeve parodontale dhe mënyrën e shërimit të përbashkët të endodontit dhe parodontit.

Njoftimi me proceset fiziologjike dhe patologjike në mukozën orale, faktorët mbrojtës të mukozës orale, mbrojtja e terapeutit dhe personelit nga burimet e mundshme të infeksionit.

Kolokvium

---

#### PROTETIKA STOMATOLOGJIKE – 1 muaj

Përfitimi i diturive bazike nga gnatologjia, marrja e masave dhe përpunimi laboratorik i inlejit dhe onlejit.

Kolokvium

---

#### MJEKËSIA INTERNE-DIABETOLOGJIA – 1 muaj

Specializanti është i obliguar që të kalojë kohën e caktuar në Klinikën interne në mënyrë që të njihet me problematikën internistike e cila mund të rrëzikojë jetën ose shëndetin e të sëmuarit gjatë shërimit endodontik të dhëmbit ( sëmundjet e gjakut, sëmundjet endokrine, çrregullimet imunologjike, ndjeshmëria ndaj disa barnave dhe anestetikëve).

Kolokvium

---

#### ***Punimet që duhet të realizohen gjatë aftësisimit:***

Gjatë stazhit specialistik, specializanti është i obliguar që nën kontrollin e mentorit të kryen këto punime:

- 20 mbushje amalgamike me kunjat retencionues,

- 5 rindërtime të dhëmbit me inlej prej ari-onlej,
- 10 rindërtime të dhëmbit me inlej prej kompoziti-onlej,
- 5 rindërtime të dhëmbit me inlej prej keramike-onlej,
- 35 rekonstrukcione me kompozite te dhëmbët e diskoloruar,
- 10 rindërtime të kurorës të dëmtuar me traumë,
- 40 shërime endodontike të pulpiteve akute te dhëmbët me shumë rrënjë, sidomos te dhëmbët me pengesa patologjike në kanale dhe me anomali morfologjike të hapësirës endodontike,
- 35 shërime endodontike të gangrenës te dhëmbët me shumë rrënjë,
- 30 shërime endodontike te dhëmbët me ndryshime akute dhe kronike periradikulare,
- 10 shërime endodontikokirurgjike (hemisekcion, separim, amputim, disekcion i rrënjëve).
- 10 implante transdentale endodontike,
- zbardhja e dhëmbëve me ndryshim të ngjyrës,
- 20 rekonstrukcione pasendodontike të kurorës së dhëmbit,
- 10 përpunime komplete me resorbim intern ose ekstern të rrënjës së dhëmbit,
- 10 përpunime të përbëra endodontikoparodontale të rrënjëve të frakturuara,
- 10 revizione tek thyerja e instrumenteve intrakanalikulare ose te perforimet e rrënjës.

Vërejtje: Çdo specializant duhet të ketë librezën ku saktësisht në formë ditari mbanë evidencën në të cilën shënon të gjitha punët e kryera.